

Meqenëse:

- Gjendja e fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë e shpallur me Vendimin Nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatëkeqësisë natyrore”, përfundon në datë 23 Qershor 2020.
- Planet e masave të marra në Republikën e Shqipërisë, si edhe në të gjithë shtetet e tjerë, për ndalimin e përhapjes së virusit COVID-19, janë lehtësuar ndjeshëm dhe po vijohet me hapjen graduale të pjesës më të madhe të kufijve tokësor dhe ajror ndërmjet shteteve.
- Vlerësohet se perspektiva e gjendjes favorizon dhe i jep mundësinë subjekteve të interesuara të përgatisin dokumentacionin dhe të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes së pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut.

Sa më sipër, në mbështetje të Dokumentave të Procedurës Konkurruese të Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut, Kapitulli II “Udhëzime për Pjesëmarrësit në Procedurën Konkurruese të Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut”, Seksioni 5, paragrafi “Të drejtat shtesë të Komisionit”, pika 5.11/ii ; **Komisioni i Posacëm**, njofton se:

1. **Shfuqizohet** masa e Pezullimit të Procedurës Konkurruese, të vendosur në datën 08.04.2020 dhe se **procedura e** përzgjedhjes së pjesëmarrësve në Kapitalin e Operatorit të Tregut do të vijojë, **bazuar në Dokumentet e Procedurës Konkurruese.**
2. Në afatin kohor për dorëzimin e propozimeve, ndryshon vetëm data e dorëzimit të propozimeve, e cila do të jetë “**jo më vonë se data 29/06/2020**”, por pa ndryshuar orët përkatëse (pwr cdo kategori), të përcaktuara në DPK.
3. Në afatin kohor për hapjen e propozimeve, ndryshon vetëm data e hapjes së propozimeve, e cila do të jetë “**29/06/2020**”, por pa ndryshuar orët përkatëse (për cdo kategori), të përcaktuara në DPK.